

**FORMULAR NR. 7**

**AKT THEMELIMI I  
SHOQERISE ANONIME  
ALB SIGURACION (ALB-SIG)**



Të nënshkruarit (sipas rendit alfabetik):

1. Bajram Xhaja
2. Shefqet Kastrati
3. Zef Preci

Të mbledhur sot më datë 18.03.2002 vendosën të hemelojnë shoqërinë anonime "**ALB SIGURACION**" sh.a, sipas parashikimit të këtij akti themelimi dhe statutit bashkangjitur.

Për këtë arsye në vendosëm për sa më poshtë:

1. Të themelohet shoqëria anonime me emrin **ALB SIGURACION**.
2. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve, si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **ALB SIGURACION** në menyre të shkurtuar **ALB-SIG** sh.a dhe shuma e kapitalit themeltar të saj.
3. Objekt i veprimtarisë së kësaj shoqërie do të jetë kryerja e veprimtarisë së sigurimeve për dëmet dhe risigurimet, në përputhje me ligjin Nr. 8081 datë 03.03.1996 "Për veprimtarinë e Sigurimeve dhe të Risigurimeve".
4. Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, atje ku është vendosur Drejtoria e Përgjithshme e saj.
5. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000.000 (njëqind milion) lekë.
6. Ai është i ndarë në 100.000 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë.
7. Organet drejtuese të shoqërisë janë:

**Asambleja e aksionerëve që përfaqësohet nga:**

1. Shefqet Kastrati
2. Bajram Xhaja
3. Zef Preci

**Këshilli Mbikqyrjes**

Përbëhet nga:

1. Zef Preci
2. Shefqet Kastrati
3. Bajram Xhaja




**Drejtori i Përgjithshëm** është z. Fatmir Mema

Këshilli i mbikqyrjes i Shoqërisë përbëhet nga tre vetë, të cilët janë caktuar nga mbledhja themeluese e shoqërisë.

Afati i ushtrimit të funksioneve dhe kompetencat e tij janë sipas statutit të shoqërisë.

8. Shoqëria autorizon Drejtorin e Përgjithshëm Z. Fatmir Mema të kryejë veprimet e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë.
9. Kapitali themeltar i aksionerëve të shoqërisë do të derdhet në Credit Bank dhe ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë të vërtetojë, sipas ekstratit bankar, derdhjet e kapitali nga secili aksioner, si dhe t'u japë vërtetime secilit për shumat e derdhura. Kapitali themeltar në momentin e nënshkrimit të akteve të themelimit të shoqërisë është i plotë dhe vërtetohet se është derdhur rregullisht nga aksionerët sipas dokumentacionit ngjitur këtij akti themelimi.
10. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e legëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e statutit.
11. Shoqëria do të nisë aktivitetin e saj që nga momenti i përfundimit të regjistrimit në Gjykatë.
12. Ekspert kontabël i shoqërisë caktohet Shoqëria AI & EI Auditors me auditues kryesor (Principal Auditor) Ek. . Nexhmie ÇELA
13. Dispozita më të hollësishme për shoqërinë caktohen në statutin e saj.

#### AKSIONERËT

1. Shefqet Kastrati 
2. Bajram Xhaja 
3. Zef Preci 



**STATUT  
i Shoqërisë  
ALB SIGURACION (ALB-SIG)**

**KAPITULLI I PARE**

**Forma ligjore  
Neni 1**

Shoqëria që krijohet është e formës shoqëri anonime pa oferte publike dhe funksionon në baze të ligjit "Per shoqërite tregtare" dhe të ligjit Nr. 8081 datë 07.03.1996 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve".

**Neni 2  
Objekti**

Shoqëria ka për objekt veprimtari të saj kryerjen e veprimtarisë së Sigurimeve për dëmet, dhe veprimtarinë e risigurimeve në përputhje me ligjin Nr. 8081 datë 07.03.1996 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve".

Shoqëria nuk do të angazhohet në veprimtari tregtare të tjera përveç atyre që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.


**Neni 3  
Emërtimi**

Emërtimi i plotë i shoqërisë është "ALB SIGURACION". Shoqëria ka shëmbël dhe vulën e saj.

**Neni 4  
Selia, degët, agjensitë dhe zyrat e përfaqësimit**

Selia e shoqërisë është në Tiranë, ku ndodhet Drejtoria e Përgjithshme e saj.

Veprimtaria e Shoqërisë në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët dhe agjencitë e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë së Përgjithshme.



**Kapitulli 2**  
**Kapitali themeltar, aksionet, ndryshimet e kapitalit**

**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000.000 lekë (njëqind milionë lekë). Ai është i ndarë në 100.000 aksione të së njëjtës kategori me vlerë nominale prej 1.000 lekë (njëmijë lekë për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre.

Aksionet janë të numërtuara nga 1-100.000 përfshirë dhe numrin e fundit të aksionit

Zoteruesit e kapitalit të shoqërisë janë aksioneret si më poshte:

Emër Mbiemër	Përqindja	Nr. Aksioneve	Vlerë në lekë
1. Shefqet Kastrati	60.00%	60.000	60.000.000 L
2. Bajram Xhaja	30.00%	30.000	30.000.000 L
3. Zef Preci	10.00%	10.000	10.000.000 L

**Neni 6**  
**Forma e aksioneve**

**Aksionet e shoqërisë janë nominative.**


Pronësia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga shoqëria, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionerit, shoqëria i lëshon atij një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.

**Neni 7**  
**Shitja dhe transferimi i aksioneve**

Përveç rastit të trashëgimisë, transferimi i pronësisë së aksioneve tek të tretet duhet të miratohet nga Këshilli i Mbikqyrjes dhe kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara nga neni 207 i ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Ne qofte se Këshilli i Mbikqyrjes ka refuzuar shitjen e aksioneve një blerësi jashtë bashkësisë së aksionerëve, Shitësi duhet të njoftojë shoqërinë me letër rekomande brenda tetë ditëve nga data e njoftimit të refuzimit, nëse ka hequr dorë nga projekti i shitjes së aksioneve. Në rast se Shitësi nuk ka hequr dorë nga ky projekt, Këshilli Mbikqyrës duhet të sigurojë blerjen e aksioneve prej një ose disa personave të zgjedhur prej tij.

Në rast se për vlerësimin e aksioneve nevojitet ekspertim, shpenzimet e ekspertimit paguhen përgjysëm nga shitësi e blerësi.





### **Neni 8**

#### **Shlyerja e aksioneve**

Aksionet për kapitalin në para të nënshkruara në zbatim të një vendimi për zmadhimin e kapitalit do të shlyhen të paktën për 50% të vlerës së tyre qysh në çastin e nënshkrimit. Pjesa tjetër e vlerës do të shlyhet me këste në bazë të vendimit për shlyerjen nga Këshilli i Mbikqyrjes.

Asambleja e jashtëzakonshme, vendos zmadhimin e kapitalit. Ajo ka të drejtë të marrë vendim për shlyerjen tërësore të aksioneve qysh në çastin e nënshkrimit ose brenda një afati të shkurtër nga ai i përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

### **Neni 10**

#### **ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë kryhet vetëm me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve dhe në pajtim me dispozitat e neneve 164-166 të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992. "Për Shoqëritë Tregtare".

Kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën shumën minimale të kërkuar nga ligji.

### **Neni 11**

#### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E LIDHURA ME AKSIONET**

Çdo aksion jep të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet vetore të shoqërisë të destinuar për shpërndarje dhe në tepricën e aktivitetit të mbetur në rastin e likuidimit, në përpjestim me aksionet që zotëron.

Pronësia mbi aksionet jep edhe të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në Mbledhjet e Asamblesë së përgjithshme në kushtet e përcaktuara me ligj në statut.

Aksionerët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të treëve dhe për humbjet e saj deri në masën e shumës nominale të aksioneve që zotërojnë. Ndalohet kërkimi i fondeve përtej kësaj shume.

Aksionet e transferueshme mbartin të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek perfituesi i aksioneve.

Pronësia mbi aksionin përmban automatikisht të drejtat që përcaktohen në statutin e Shoqërisë dhe të votes në përpjestim me aksionet që zotëron në procesin vendimmarres në Asamblenë e aksionerëve.

**KAPITULLI 3**  
**Drejtimi i shoqërisë**

**Seksioni 1**  
**Drejtoria**

**Neni 12**  
**PËRBËRJA DHE EMËRIMI**

Drejtimi i shoqërisë kryhet nga drejtoria, e cila përëhet nga drejtori i përgjithshëm dhe disa anetare, Numri dhe përberja e drejtorisë caktohen me vendim të keshillit mbikqyres.

Drejtoria emërohet nga keshilli mbikqyres i shoqërisë dhe ushtron funksionet sipas statutit dhe nën-kontrollin e Këshillit të Mbikqyres.

Drejtor i parë emërohet Z. Fatmir Mema.

**Neni 13**  
**Kohëzgjatja ne funksion e drejtorit të përgjithshëm**

Drejtori i përgjithshëm emërohet për një periudhë 4 (katër) vjeçare. Ai është i rizgjedhshëm. Shkarkimi i tij bëhet nga keshilli mbikqyres,

Drejtori i Përgjithshëm mund ta mbajë këtë funksion deri në moshën 65 vjeç.

Zëvendësimi i përkohshëm i Drejtorit të Përgjithshëm bëhet me vendim të keshillit mbikqyres deri në marrjen e vendimit për emerimin e drejtorit të ri

**KOMPETENCAT E DREJTORIT TE PERGJITHSHEM**

Drejtori i Përgjithshëm ushtron të gjitha kompetencat që nuk i ka Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Keshilli Mbikqyres. Ai është i vetmi perfaqësues ligjor i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet.

**Neni 14**  
**Shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i përgjithshëm mund të shkarkohet gjatë mandatit të tij kur:

1. Është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale, që ka lidhje me veprimtarinë ekonomike-financiare.
2. Është vërtetuar se ka shpërdoruar fondet e shoqërisë.

3. Janë rastet e parashikuara në nenin 98 të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
4. Kur ka humbur besueshmerine e aksionereve, gjatë ushtrimit të detyres për administrimin e shoqërisë.

### Neni 15 FUNKSIONIMI I DREJTORISE

Drejtoria, si rregull, funksionon si organ kolegjal. Drejtorët shoqërisë emërohen nga Këshilli i Mbikqyrjes me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, të cilët përcaktojnë edhe funksionet e drejtorëve teknikë, në pajtim me rregulloren e shoqërisë.

Drejtorët teknikë nuk kanë asnjë kompetencë për të përfaqësuar shoqërinë në lidhje me të tretët, vetëm kur Drejtori i Përgjithshëm u ka kaluar atyre me mandat një pjesë të kompetencave të tij.

Anëtarët e drejtorisë, në zbatim të urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm ose të Këshillit Mbikqyrës, mund të nxjerrin akte individuale për sektorin të cilin ata mbulojnë.

### Neni 16 PERFAQESIMI I SHOQERISE

Shoqëria përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm ose i autorizuar i tij, para të gjithë institucioneve publike e private, organeve gjyqësore, si dhe në marrëdhëniet me të tretët. Me përjashtim të kompetencave që ligji ia ka caktuar shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve dhe kompetencave të specifikuara të Këshillit Mbikqyrës.

### Neni 17 MBLEDHJET E DREJTORISE DHE VENDIMET

Mbledhja e drejtorisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, ose personi i autorizuar rregullisht prej tij.

Mbledhjet e drejtorisë zhvillohen, si rregull, në selinë e shoqërisë. Ato drejtohen nga drejtori i Përgjithshëm, që kryen edhe procedurat e nevojshme për drejtimin e mbledhjes. Vendimet merren me shumicë votash:

#### **Përgjegjësia e anëtarëve të drejtorisë**

Anëtarët e drejtorisë janë përgjegjës, civilisht dhe penalisht, për aktet e drejtimit të tyre, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

**SEKSIONI 2**  
**KESHILLI MBIKQYRES**

**Neni 22**

Këshilli mbikqyres përbëhet nga tre anëtarë. Perjashtim sht ka me shumë se tre anëtarë në rastin e percaktimeve nga ligji për rastet e bashkimit me një shoqëri tjetër. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës janë:

1. Zef Preci
2. Shëfqet Kastrati
3. Bajram Xhaja

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen nga mbledhja e zakonshme e asamblese së aksionerëve, për një kohë prej një vjetësh. Në emërimin e anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes respektohen papajtueshmëritë, apo ndalesat ligjore.

Funksionet e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës përfundojnë normalisht në mbarim e afatit të mandatit të percaktuar në statut.

Anëtarët e Këshillit të Mbikqyrjes janë të rizgjedhshëm.

Ata mund të shkarkohen në çdo kohë nga mbledhja e zakonshme e asamblese së aksionerëve.

**Neni 23**

**Personi juridik anëtar i Këshillit të Mbikqyrjes**

Një person juridik që është aksioner i shoqërisë mund të jetë anëtar i Këshillit Mbikqyrës. Në këtë rast ky duhet të caktoj, qysh në çastin e zgjedhjes, një përfaqësues të përhershëm, person fizik, i cili u nënshtrohet të njëjtave të drejta dhe detyrime që ka çdo anëtar i këshillit, duke mos përjashtuar nga përgjegjësia e përbashkët personin juridik që ai përfaqëson.

Nëqoftëse personi juridik ia heq mandatin përfaqësuesit të tij, duhet të njoftojë për këtë shoqërinë menjëherë dhe të bëjë njëkohësisht zëvendësimin e tij. Ky rregull do të zbatohet dhe në rastet e vdekjes, të dorëheqjes ose të pengimeve të zbatueshme të përfaqësuesit të përhershëm.

**Neni 24**

**EMERIMI I KRYETARIT TË KESHILLIT TË MBIKQYRJES**

Kryetari i Këshillit të Mbikqyrjes zgjidhet nga anëtarët e këshillit mbikqyres në mbledhje të parë të tij.

Kryetari i Këshillit të Mbikqyrjes është detyrimisht person fizik.



Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë, gjithashtu, një sekretar, qoftë edhe jashtë anëtarëve të tij, duke caktuar dhe kohëzgjatjen e funksioneve të tij.

Kryetari i Këshillit dhe sekretari janë të rizgjedhshëm.

## Neni 25

### Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

Këshilli i Mbikqyrjes është organ kolegjal, përgjegjës dhe mbikqyrës për shoqërinë. Ai bën shqyrtimin dhe merr vendime në mbledhjet të tij.

Këshilli i Mbikqyrjes mbledhet një herë në tre muaj dhe së herë që e kërkon interesi i shoqërisë. Ai mbledhet gjithashtu në fund të çdo trimujori për të dëgjuar raportin e drejtorit të përgjithshëm.

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës thirren nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtarët e tjerë të këtij Këshilli.

Kryetari dhe, në mungesë të tij, njëri nga anëtarët duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Brenda 15 ditësh, kur 1/3 e anëtarëve të këtij Këshilli i parqesin atij një kërkesë të arsyetuar për këtë. N.q.se kërkesës nuk i jepet rrugë, autorët e saj mund të procedojnë vetë në thirrjen e mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës, duke treguar vendin e ditëstë mbledhjes.

Mbledhjet e Këshillit të Mbikqyrjes së Drejtuesve mbahen në selinë e shoqërisë, ose në një vend tjetër të treguar në thirrje.

Si rregull, thirrja e mbledhjes duhet t'u dërgohet anëtarëve të Këshillit 3 ditë përpara me letër, telegram ose formë tjetër të shkruar komunikimi.

Çdo thirrje duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës.

Mbledhjet e Këshillit të Mbikqyrjes drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtari me moshë më të madhe.

## Neni 26

### Vendimet e Këshillit Mbikqyrjes

Këshilli merr vendime të vlefshme kur në një mbledhje të tij janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve në funksion.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Çdo anëtar i këshillit ka vetëm një votë.

Megjithatë, kur Këshilli i Mbikqyrjes është mbledhur për të vendosur mbi një projekt të shitjes së aksioneve një të treti aksioner, në kushtet e parashikuara në nenet e mësipërme të këtij statuti, vendimi i miratimit merret me shumicën ¾ të votave të anëtarëve të pranishëm, ose të përfaqësuar. N.q.se shitësi i aksioneve është anëtar i këshillit të drejtuesve, ai nuk merr pjesë në votim. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit të seancës është përcaktuese.

## Neni 27

### Dokumentimi i mbledhjeve dhe vendimeve

Këshilli i Mbikqyrës mban proces-verbale të mbledhjeve të tij, i cili firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe sekretar.

Evidentimi i numrit të anëtarëve në funksion dhe i emërimit të tyre provohet në mënyrë të vlefshme ndaj të tretëve vetëm nga tregimi në process verbalin në i firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

Evidentimi i numrit të anëtarëve në funksion dhe i emërimit të tyre provohet në mënyrë të vlefshme ndaj të tretëve vetëm nga pasqyrimi në proces verbalin e mbajtur në çdo mbledhje të emrave të anëtarëve të pranishëm, të përfaqësuar.

Shqyrtimet dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës evidencohen me anë të proces-verbaleve të mbajtura në një libër të posaçëm (protokoll), të numërtuar dhe të vulosur, që mbahet në selinë qendrore të shoqërisë, në të cilin tregohen përveç të tjerash anëtarët e pranishëm, të përfaqësuar dhe të munguar, si dhe çdo person tjetër që ka asistuar në mbledhjen e Këshillit, tërësisht ose pjesërisht.

## Neni 28

### KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Këshilli mbikqyrës ushtron ato kompetenca, të cilat janë të parashikuara në ligjin nr. 7838, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", seksioni i shoqërive anonime, me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia kanë rezervuar asamblesë së përgjithshme të aksionerëve, ose drejtorit të përgjithshëm.

Aktet dhe operacionet e renditura më poshtë janë në kompetencë vetëm të Këshillit Mbikqyrës:

#### 1. Miratimi i rregulloreve të brendshme të shoqërisë, që përcaktojnë:

- Strukturën e organizimit dhe administrimit të shoqërisë, duke përfshirë dhe njësitë funksionale dhe administrative të saj;
- Detyrat e çdo drejtori departamenti dhe të njërive që ai drejton dhe mbikqyr;
- Funksionet e komitetit të kontrollit të brendshëm dhe të komiteteve të tjera të brendshme, të ngritura nga këshilli i drejtuesve.

#### 2. Miratimi dhe mbikqyrja e zbatimit të politikës së shoqërisë për:

- Llojet, kushtet dhe afatet e policave të sigurimit;
- Kushtet dhe kriteret sipas të cilave shoqëria mund të negociojë me institucione financiare të tjera, vendase apo të huaja, për të marrë hua, si dhe kufijtë e huamarrjes;

c) Zgjerimin e veprimtarisë së shoqërisë, produkte të reja brenda kufijve të caktuar në licensën e lëshuar nga Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve.

3. Miratimi i numrit të përgjithshëm të personelit të shoqërisë, i kritereve të marrjes në punë të personelit teknik, i të belave të pagave dhe kritereve për dhënien e shpërblimeve suplementare.

4. Përgatitja dhe paraqitja për shqyrtim në mbledhjen e përgjithshme të aksionerëve të gjendjeve financiare vjetore dhe tremujore dhe të raporteve të veprimtarisë.

5. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë që kjo është e nevojshme dhe në mbyllje të çdo viti financiar për të miratuar gjendjen financiare vjetore.

### Neni 29

#### INFORMIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e shoqërisë informacion për çështje të natyrës administrative, teknike dhe financiare, që i mundësojnë atij të verifikojë dhe gjykojë për kushtet në të cilat zhvillohet veprimtaria e shoqërisë dhe të jetë plotësisht i qartë për vendimet që duhen marrë, apo që do të merren nga ana e Këshillit.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës duhet të njoftohet personalisht për Mbledhjet e Këshillit dhe duhet t'i vihet në dispozicion në selinë e shoqërisë, apo t'i dërgohen, bashkë me thirrjen, dokumentat dhe raportet që do të shqyrtohen në mbledhje.

Shoqëria nuk është e detyruar t'u japë anëtarëve të Këshillit të mbikqyrës kopjet e proces verbaleve të vendimeve të Këshillit, por çdo anëtar mund të kërkojë që të njihet me to në selinë e saj.

Mosnjohja e të drejtave të çdo anëtari të Këshillit për informacionet e mësipërme dhe mosthirrja në mbledhjet e Këshillit, sjell pavlefshmërinë e vendimeve të Këshillit.

### Neni 30

#### PERGJEGJESITE E ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKQYRËS

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mbajnë përgjegjësi civile solidarisht dhe individualisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë për vendimet që ato marrin dhe kanë rezultuar në kundërshtim me dispozitat ligjore ose të rregullimeve të zbatueshme për veprimtarinë e shoqërisë, për shkeljen e statutit, si dhe për gabimet e bëra në administrimin e shoqërisë për shkak të vendimeve të tyre.

Përgjegjësia penale e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës përcaktohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

### Neni 31

#### SHPERBLIMI I VEÇANTE PËR PJESEMARRJEN NË KËSHILL DHE SHPERBLIMET E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e zakonshme mund t'u caktojë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës si shpërblim për pjesëmarrjen në këshill një shumë vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri në një vendim tjetër të asamblesë.

Këshilli Mbikqyrës mund të caktojë shpërblime të jashtëzakonshme për anëtarët, të cilëve u ngarkohen misic e apo u jepen mandate për shërbime apo detyra të caktuara. Shpërblimet e veçanta dhe të jashtëzakonshme përballohen nga llogaria e shoqërisë.

### Neni 32

#### Detyrimi për të ruajtur sekretin

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Drejtori i Përgjithshëm dhe të gjithë personat e punësuar dhe agjentë të shoqërisë, janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni gjatë kryerjes së detyrave në shoqëri dhe asnjëherë të mos e përdorin atë për përfitime personale apo për të tretë.

## KAPITULLI 4

### ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

### Neni 33

#### Mbledhja e Asamblesë dhe efektet detyruese të vendimeve

Mbledhjet e asamblesë së Aksionerëve janë të zakonshme ose të jashtëzakonshme, në varësi të natyrës së çështjeve që diskutohen dhe vendimeve që do të marrë.

Çdo Asamble e mbledhur rregullisht përfaqëson tërësinë e aksionerëve me të drejtë vote.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme detyrojnë të gjithë aksionerët, madje edhe ata që mungojnë në mbledhje apo që votojnë kundër.

### Neni 34

#### Organizimi i mbledhjeve të asamblesë

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Këshilli Mbikqyrës

Ajo mund të thirret gjithashtu, edhe nga një mandati mbajtës i caktuar nga gjykata dhe, kur është rasti, nga likujduesi. Asambletë e Përgjithshme mblidhen në selinë e shoqërisë, ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje. Thirrja e Asamblesë së aksionerëve bëhet me anë të njoftimit që i dërgohet çdo aksioneri në adresën e tij me letër rekomande.

Njoftimi duhet të bjerë në dorën e aksionerëve apo të njihet prej tyre 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë dhe duhet të përmbajë ditën, orën, vendin e mbledhjes, natyrën e asamblesë dhe rendin e ditës.

Kur asambleja nuk ka mundur të marrë vendim për shkak se nuk është shqyrtuar pjesëmarrja e kërkuar, mbledhja e dytë do të bëhet jo më vonë se një muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë, në të njëjtat forma si e para.

Njoftimi ose letra e thirrjes së mbledhjes së dytë rikujtojnë ditën, orën, vendin e mbledhjes, natyrën e asamblesë dhe rendin e ditës.

### **Neni 35 RENDI I DITES**

Rendi i ditës së mbledhjes së asamblesë përcaktohet nga autori i thirrjes. Një ose disa aksionerë që përfaqësojnë të paktën 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë kanë të drejtë të kërkojnë që të futen në rendin e ditës një ose disa projekt-rezoluta. Këto projekt-rezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë bashkangjitur me një kërkesë në të cilën tregohen edhe arsyet, si dhe me një dokument që provon zotërimin e pjesës të kapitalit themeltar të kërkuar nga paragrafi i dytë i këtij neni.

Projekt-rezoluta dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbërrijnë në selinë e shoqërisë të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

Asambleja e aksionerëve nuk mund të marrë në shqyrtim një çështje që nuk është përfshirë në rendin e ditës. Megjithatë ajo mundet në çdo rrethanë të shkarkojë një ose disa anëtar të këshillit mbikëqyrës, drejtorin e përgjithshëm dhe të bëjë zëvendësimin e tyre.

### **Neni 36 HYRJA NE ASAMBLE**

Çdo aksioner, pavarësisht nga numri i aksioneve që zotëron, ka të drejtë të asistojë në mbledhjet e asambleve të përgjithshme dhe të marrë pjesë në vendimet e tyre personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi. Hyrja në mbledhjet e asambleve të përgjithshme bëhet në bazë të një dokumenti, që provon identitetin e aksionerit si dhe të regjistrimit të tij në regjistrin e aksionerëve të shoqërisë. Çdo aksioner

mund të përfaqesohet në mbledhjet e asamblesë në kushtet e parashikuara nga ligji.(prokure)

### Neni 37

#### **EVIDENCA E PJESEMARRJES, DREJTIMI I MBLEDHJES DHE PROCES-VERBALET.**

Për çdo mbledhje të asamblesë evidentohet prezenca e aksioneve për të plotësuar quorumin e percaktuar ne ligj për të qene mbledhja e vlefshme. Mbledhjet e asamblesë drejtohen nga Kryetari i saj i cili është i zgjedhshëm në çdo mbledhje nga vetë aksionerët, me përqindjen e, thjeshtë të votave të aksionerëve pjesëmarrës në mbledhjet.

Në rastet kur thirrja e mbledhjes është bërë nga kontrollori i pavarur, mandati mbajtësi i caktuar nga gjykata apo likujduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Për çdo mbledhje të asamblesë hartohet një procesverbal i cili përmban:

- Datën dhe vendin e mbledhjes
- Mënyrën e thirrjes
- Rendin e ditës
- Drejtuesin e mbledhjes dhe komisioni i vëzhgimit
- Numri i aksioneve që marrin pjesë në votim
- Pjesëmarrja e arritur
- Përmendjen e dokumenteve dhe të raporteve që janë shtruar në mbledhje
- Një përmbledhje të debateve

Tekstet e projekt-rezolutave të vëna në votim ato të miratuara dhe ato të hedhura poshtë nga aksionerët

Proces-verbalet e mbledhjes së asamblesë hartohen në një regjister të posaçëm të numërtuar dhe të vulosur, i cili ruhet në selinë e shoqërisë.

### Neni 38

#### **PJESËMARRJA, VOTIMI DHE NUMRI I VOTAVE**

Në asambletë e përgjithshme, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme pjesëmarrja llogaritet për tërësinë e aksioneve që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë. E drejta e votës që u përket aksioneve është përpjestimore me kapitalin që ato përfaqësojnë.

Çdo aksion i jep zotëruesit të paktën të drejtën e një vote. Kryetari i asamblese percakton menyren e votimit dhe radhen e ces tejeve ne shqyrtim. Votimi kryhet i veçantë për çdo çështje apo vendim.

1327

**Neni 39**  
**ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

Asambleja e zakonshme mbledhet të paktën një herë në vit brenda 6 muajve të vitit pasardhës për të vendosur mbi llogaritë e shoqërisë për ushtrimin financiar.

Ajo ka merrë të tjerash kompetencat që vijojnë:

- Të miratojë strategjinë e zhvillimit afatgjatë të shoqërisë
- Të miratojë plan-biznesin dhe planin financiar vjetor
- Të miratojë, të ndryshojë, të hedhë poshtë llogaritë vjetore që janë shtruar për miratim
- Të vendos për shpërndarjen dhe destinimin e rezultatit në pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin
- Të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e këshillit mbikëqyrës
- Të emërojë kontrollorin ose kontrollorët e pavarur të shoqërive (ekspertët kontabël të autorizuar)
- Të miratojë ose të mosmiratojë emërimet e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të kryera nga vetë këshilli si emëime të përkohshme
- Të miratojë pagën e drejtorit të përgjithshëm dhe raportet e pagave për kategoritë e tjera të personelit të shoqërisë si dhe shpërblimet suplementare që mund të jepen për punë apo rezultate të mira
- Të caktojë shpërblimin e veçantë dhe shpërblime të tjera të parashikuara në këtë statut për këshillin mbikëqyrës
- Të vendos për raportin e kontrollorit të pavarur lidhur me marrëveshjet që i nënshtrohen autorizimit paraprak për këshillin e mbikëqyrjes

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim që nuk sjell ndryshime të statutit.

Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë veçim kur aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë jo më pak se 60% të aksioneve me të drejtë vote.

Në rast se mbledhja e parë nuk realizohet për mbledhjen e dytë nuk kërkohet asnjë lloj pjesëmarrje.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm apo të përfaqësuar.

**Neni 40**  
**ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME**

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mblidhet sa herë që duhet të merret një vendim që sjell ndryshime të këtij statuti.

Ajo nuk mund të shtojë detyrimet e aksionerëve përveç operacioneve që rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në mbledhjen e parë vetëm kur aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e aksioneve me të drejtë vote.

Për mbledhjen e dytë kjo pjesëmarrje është jo më pak se  $\frac{1}{2}$  e aksioneve me të drejtë vote. Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme merren me shumicën prej  $\frac{3}{4}$  të votave që u përkasin aksionerëve të pranishëm ose të përfaqësuar.



#### Neni 41

### VENJA NË DISPOZICION TË AKSIONERËVE TË DOKUMENTEVE DHE INFORMACIONEVE

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionerëve në kushtet dhe në afatet e parashikuara nga ligji raportet, dokumentat dhe llogaritë vjetore që shqyrton asambleja.

Me përjashtim të inventareve dhe ndonjë dokumenti jetër të caktuar nga asambleja dokumentat që duhet tu vihen në dispozicion të aksionerëve u dërgohen së bashku me njoftim thirrjen për mbledhje.

#### KAPITULLI 5

### KONTROLLORET E PAVARUR "EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR"

#### Neni 42

### EMËRIMI DHE SHPËRBLIMI

Asambleja e përgjithshme e aksionerëve cakton një kontrollor ose një grup kontrollorësh të pavarur, të zgjedhur nga lista e institutit të ekspertëve. Në caktimin e kontrollorëve të pavarur mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara nga ligji Nr 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Kontrollorët e pavarur caktohen për një kohë që i përgjigjet ushtrimit financiar. Ata janë të ricaktueshëm. Kontrollori i parë i pavarur do të jetë Shoqëria AI & EI Auditors me auditues kryesor (Principal Auditor) Ek.a. Nexhmie ÇELA

Shpërblimi i kontrollorëve të pavarur caktohet nga asambleja e aksionerëve dhe përballohet nga shoqëria.

1261



**Neni 43**  
**DETYRAT DHE TË DREJTAT**

Detyrat dhe të drejtat e kontrollorëve të pavarur të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Asambleja e aksionerëve mund ti kërkoj kontrollorëve të pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve të posaçme për çështje në interes të shoqërisë.

Ekspertët kontabël të miratuar thirren në mbledhjen e drejtorisë që mbyll llogaritë e vitit financiar të mbyllur si dhe në të gjitha mbledhjet e aksionerëve.

Me marrjen e raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar ato miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë.

Raportet që ato përgatitin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

**KAPITULLI 6**  
**KONTABILITETI, GJENDJET FINANCIARE, ÇAKTIMI I**  
**REZULTATIT**

**Neni 44**  
**KONTABILITETI, INVENTARI, GJENDJET FINANCIARE**

Shoqëria mban kontabilitetin e saj në pajtim me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin" dhe me rregullimet kontabël specike për shoqëritë e sigurimeve.

Inventarizimi i aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë kryhet një herë në vit përpara se sa të mbyllet gjendja financiare vjetore. Në mbyllje të çdo viti financiar por jo më vonë se tre muaj nga data e mbylljes së vitit, shoqëria përgatit gjendje financiare vjetore sipas rregullave të caktuara për këtë qëllim.

Viti financiar për të cilin përgatiten dhe publikohen gjendjet financiare të shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

**Neni 45**  
**REZULTATI FINANCIAR**

Rezultati financiar i vitit nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe pas dhënies së raportit përfundimtar nga ekspertët kontabël të autorizuar.

1321

**Neni 46**  
**FITIMI I SHPËRNDARSHËM - DIVIDENTI**

Fitimi i shpërndarshëm si dividend përbëhet nga fitimi neto i vitit financiar i pakësuar me humbjet e mbartura dhe me shumën e hequra për rezervat në zbatim të ligjit dhe të statutit dhe i shtuar nga fitimet e mbartura.

Fitimi i shpërndarshëm ndahet midis të gjithë aksionerëve në përpjestim me numrin e aksioneve që zotëron secili prej tyre.

Shoqëria nuk mund të shpërndaj dividendë n.q.s. kapitalit e veta janë ose do të bëhenin, si rrjedhojë e shpërndarjes më të vogla nga shuma e kërkuar nga ligji.



**Neni 47**  
**HUMBJET DHE MBARTJA E TYRE**

Pas miratimit të gjendjeve financiare vjetore nga asambleja e përgjithshme humbja e rezultuar në një vit financiar mbartet në vitet pasuese për tu mbuluar nga fitimet e ardhshme deri në shuarjen e humbjes.

**KAPITULLI 7**  
**DEGET E SHOQERISE**

**Neni 48**  
**STATUSI I DEGËS**

Dega e shoqërisë është njësia bazë organizative e saj dhe varet nga drejtoria e përgjithshme.

Dega e shoqërisë krijohet në bazë rrethi apo rajoni dhe ka në vartësi agjensi dhe zyra të shoqërisë.

**Neni 49**  
**DREJTIMI I DEGËS SË SHOQËRISË**

Drejtimi dhe administrimi i degës ushtrohet nga drejtori i saj, i cili përgjigjet për të gjithë veprimtarinë e degës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që veprojnë në fushën e sigurimeve, udhëzimet e drejtorisë së përgjithshme dhe dispozitat e këtij statuti.

Drejtori i degës në përputhje me strukturën organizative dhe numrin e punonjësve të miratuar emëron dhe shkarkon punonjësit dhe përcakton pagat e tyre mujore në përputhje me tabelën e pagave të miratuar nga këshilli i mbikëqyrjes.

**Neni 50**  
**RAPORTIMET E DEGES**

Dega i dërgon drejtorisë së përgjithshme në afatet e përcaktuara prej saj bilancin me relacionin shoqërues dhe evidencat e tjera statistikore si dhe çdo informacion tjetër që i kërkohet.

**KAPITULLI 8**  
**DETYRIMET NDAJ KOMISIONIT TË MBIKËQYRJES SË**  
**SIGURIMEVE**

**Neni 51**

Shoqëria Alb-Sig Sh.a. në bazë të nenit 24 të ligjit 8081 datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve" ka për detyrim që përpara se ti shtrojë Asamblesë së Përgjithshme ndryshimet e statutit duhet të marrë miratimin e Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Në rast të aprovimit të ndryshimeve të statutit nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, ndryshimet e statutit quhen të miratuara.

Shoqëria Alb-Sig sh.a. në bazë të nenit 27 të ligjit 8081 datë 7.3.1996 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve" ka për detyrim që duhet ti bëjë të ditur Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve përpara kryerjes së çdo operacioni shitje të aksioneve një aksioneri person fizik ose juridik, që i jep këtij të fundit drejt përdrejtë ose tërthorazi një pjesëmarrje që arrin më shumë se një të njëzetën, një të dhjetën, një të pestën, një të tretën, një të dytën ose më të tretat e kapitalit themeltar apo të drejtave të votës. Çdo operacion shitjeje duhet të bëhet vetëm me autorizim të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Çdo person fizik apo juridik që propozon të blejë direkt ose indirekt një masë aksionesh që arrin ose tejkalon 20 përqind të aksioneve të shoqërisë ose të drejtave votuese duhet të njoftojë Komisionin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, duke treguar edhe masën e pjesëmarrjes.

**AKSIONERET:**

1. Shefqet Kastrati, i biri i Jonuzit, datelindja 05 Qershor 1961, i pajisur me leternjoftimin nr. 0012701, leshuar nga Ministria e Rendit Publik, banues ne adresen:Rruga "Tajlanda" Pll.216, shk.3, ap.43 Durres,
2. Bajram Khaja i biri i Ymerit, datelindja 22 Shkurt 1937, pajisur me leternjoftimin nr. 1900747, leshuar nga Ministria e Rendit Publik,

banues ne adresen: Rruga: Hamid Shijaku, Pallati 6, Shk. 1, Apt. 11  
Tirane,

3. Zef Preci i biri i Nushit, datelindja 5 Mars 1958, i pajsur me  
leternjoftimin nr. 001437, leshuar nga Ministria e Punëve të  
Jashtme, banues ne adresen: Rruga: Dede Gjo Luli, Pallati Perballe  
INIMA, Apt. 4/3, Tirane.

**Shenim:** Statuti i shoqerise duhet te jete i nenshkruar prej te gjithe  
anetareve te Drejtorise

Emri, Atesia, Mbiemri

1. Shefqet Kastrati

2. Bajram Xhaja

3. Zef Preci

Nenshkruari

*Shefqet Kastrati*

*Bajram Xhaja*

*Zef Preci*

*13/7*

